

**Ma. Anisa Ymeri\***

## **Burimet njerëzore dhe financiare në mungesë; media lokale drejt 'tkurrjes' ekstreme**

### **Abstrakt**

Mediat gjeneraliste, ato kombëtare dhe ato juridikisht lokalet por që transmetojnë thuajse në të gjithë territorin e vendit dhe të gjitha nga Tirana, informacionin lokal, e kanë periferik. Në këto kushte, veçse pjesërisht, lokalja nuk është e pranishme në peizazhin audoviziv të Shqipërisë. Nga ana tjetër, vetë media lokale e cila edhe në statusin e saj juridik, ka të përcaktuar transmetimin e informacionit në një hapësirë dhe për një hapësirë të kufizuar, nuk e përmbush misionin e saj. Por ndërsa epoka e transmetimeve digjitale po afron, rreziku që i kanoset këtyre mediave lokale, me kapacitetin aktual që kanë është shumë i madh pasi do të jetë shumë e vështirë që të përmbushin standardet e këtij procesi dhe të ekzistojnë. Përkundër kësaj, ka një audiencë të madhe në numër, e cila është shumë e interesuar që të marrë informacion nga mediat lokale të cilat vlen të theksohet, janë domosdoshmëri për demokracinë lokale.

Hipoteza e kërkimit: Në kushtet e mungesës së financimeve burimeve njerëzore, në epokën transmetimeve digjitale e cila do të përmbysë shumë raporte, media lokale rrezikon të tkurret' edhe më tej, duke u bërë edhe më inekzistente.

Metodologjia: Analizë e kapaciteteve fizike të operatorëve lokalë referuar teknologjisë që ka në përdorim, personave të punësuar dhe orëve të transmetimit. Për të bërë këtë analizë do të shërbejnë edhe intervista me disa ndër gazetarët e mediave lokale që thuajse në çdo rast janë edhe korrespondentë të mediave qendrore; intervista me pronarë të mediave lokale për të analizuar sfidën e medias lokale në kohën e transmetimeve digjitale.

Rezultatet e pritshme të kërkimit: Media lokale, në kushtet aktuale të ekzistencës së saj, do ta ketë shumë të vështirë mbijetesën, sidomos në një proces digjitalizimi në vijim dhe që ende nuk dihen se cilat do të jenë kushtet e reja me të cilat duhet të përballen operatorët lokalë në Shqipëri sot.

**Fjalët kyçe:** mediet lokale, kapacitetet fizike, burime njerëzore, burime financiare

---

\* Autore programi, gazetarë pranë Radiotelevizionit Shqiptar dhe pedagoge e jashtme pranë Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës.

## **Hyrje**

Mediat gjeneraliste, kanalet televizive kombëtare dhe kanalet juridikisht lokale, që transmetojnë thujtse në të gjithë territorin e vendit dhe të gjitha nga Tirana, informacionin lokal e kanë thujtse periferik. Në edicionet e tyre informative, ndonëse i drejtohen një audience kombëtare, informacioni që ato përcjellin nuk është gjithëkombëtar por është i përqendruar kryesisht në ngjarjet që ndodhin në kryeqytet.

Edhe në rastet kur ka përpjekje për të trajtuar dukuri lokale, e kanë të pamundur që të mbulojnë detaje të rëndësishme. Ndaj, faktorë dhe aktorë të informacionit të tyre janë personazhet politike dhe publike që veprojnë në Tiranë. Ndodh, që kamerat e televizioneve që transmetojnë nga kryeqyteti, zhvendosen në të tjera qytete, por edhe këtë herë për veprimtaritë e politikës së Tiranës dhe rrallë për çështje që kanë lidhje me komunitetet e qyteteve prej nga transmetojnë.

Mungesa e vizionit, mungesa e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, shndërrohet në pengesë serioze duke çuar në ngushtimin e hapësirës gjeografike ku lajmi prodhohet. Kështu, informacioni lokal është pak i pranishëm në peizazhin audioviziv të Shqipërisë. Por ky është raporti i medias gjeneraliste, i ekranit kombëtar dhe atij lokal gjeneralist me informacionin lokal. Nga ana tjetër, ky realitet nuk ka pse të diktojë realitetin e medias lokale. Megjithëkëtë duket se e ka diktuar pasi nga vëzhgimi për llogari të këtij kërkimi, rezulton se është e etur për të kopjuar median gjeneraliste në programacionin e saj.

## **Hipoteza**

Në përvijim të këtij kërkimi, hipoteza që synon të vërtetohet është:

Mungesa e burimeve njerëzore dhe burimeve financiare, në epokën transmetimeve digjitale, një proces ky i cili do të përmbysë shumë raporte, media lokale rrezikon të tkurret edhe më tej, duke u bërë edhe më inekzistente se sa është aktualisht në peizazhin audioviziv të Shqipërisë.

### **Media lokale VS informacioni lokal**

Në kushtet e “territ” të informacionit lokal në median gjeneraliste kombëtare dhe atë lokale me transmetim gati – gati kombëtar, peshën specifike do të duhej ta mbante media lokale. Por cili është realiteti i saj sot?

Nga kërkimet rezulton se media lokale, e cila në statusin e saj juridik ka të përcaktuar transmetimin e informacionit në një hapësirë dhe për një hapësirë të kufizuar, nuk e përmbush misionin e saj. Ky është një përfundim i cili është i mbështetur në vëzhgimin e transmetimeve të disa kanaleve televizive lokale, të cilat megjithë statusin prej mediaje lokale, informacionin lokal nuk e kanë përparësi dhe nuk thellohen në këtë lloj informacioni i cili ka audiencën e tij absolute. Radio dhe televizione që kanë licencë për transmetime lokale shpesh nuk e shohin këtë status edhe të lidhur me përmbajtjen e programacionit të tyre, por vetëm me hapësirat e mbuluara prej tyre.<sup>1</sup>

Për rrjedhojë, mediat lokale u ngjajnë mediave kombëtare nga programacioni. Kjo sjell që shumë prej hapësirave të transmetimit të tyre, të mos u kushtohen problemeve të komuniteteve për të cilat transmetojnë. Duke e lënë mënjanë diskutimin për cilësinë dhe profesionalizmin e medias lokale, studiuesit e komunikimit mendojnë se ka realisht një audiencë të madhe në numër, e cila është shumë e interesuar për të marrë informacion nga mediat lokale, të cilat veç informimit, vlen të theksohet se janë domosdoshmëri për demokracinë lokale.

Gjithashtu, informacioni ndihmon në përfshirjen e individit në grupin e tij: ai është instrument i kësaj përfshirjeje<sup>2</sup>. Po sipas studiuesit Balle, ngjarjet e raportuara mundësojnë dhe simbolizojnë përkatësinë e secilit person në grupin e tij. Siç do të vërejë Berelson-i, njeriu e di se ç’ndodh rreth tij: “afë shtypit”, ai e ka ndjenjën e pjesëmarrjes dhe kjo ia rrit në mënyrë të ndjeshme prestigjin.

---

<sup>1</sup> Fuga, Artan. Komunikimi në Shoqërinë Masive, Papirus, Tiranë 2015. F.502

<sup>2</sup> Balle, Francis. Mediat dhe Shoqëritë, Botim, shtyp, kinema, Radio, Televizion, Internet. F.625

### **Audienca e medias lokale në Shqipëri**

Po sa pjesëmarrëse dhe sa e mundur është që në realitetin aktual të medias lokale, ngjarjet e raportuara të mundësojnë dhe të simbolizojnë përkatësinë e personave të secilit grup?

Cili është raporti media lokale – audiencë në Shqipëri?

Sa dijeni ka audiencia për çfarë ndodh përreth saj në një moment të caktuar, në një qytet të caktuar?

Sa pjesëmarrëse është audiencia në informacion dhe sa e përfshirë është?

Përkundër audiencës potenciale, nga një monitorim 1-Javor i disa televizioneve lokale të qyteteve të mëdha (*Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Fier, Vlorë*) rezulton se hapësirën më të madhe edhe në ekranet e tyre e zë informacioni “importuar” që lidhet me ngjarje, deklarata dhe veprimtari të ‘importuara’ nga Tirana, e cila ka marrë edhe statusin e kryeqendrës së informacionit. Dhe bëhet fjalë për informacion përgjithësisht të gatshëm dhe të unifikuar, duke e shndërruar edhe median lokale në këtë rast në kanal transmetimi të një produkti të gatshëm mediatik, i cili në të shumtën e rasteve nuk ka lidhje gjeografike dhe as interesi me target – grupin të cilit i drejtohet. Inversi është inekzistent, sepse media lokale deri sot, nuk e ka pasur fuqinë që të jetë në rolin e furnizuesit me informacion për median kombëtare dhe thujtase asnjëherë nuk ka shërbyer si burim informacioni ose shërbimi për ‘median e Tiranës’.

Duke qenë kjo logjika e funksionimit të medias lokale, është shndërruar në normalitet që të ndodhë edhe kështu:

*Gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të vitit 2015, televizioni ‘Skampa’ në Elbasan (në pronësi të krye bashkiakut Qazim Sejdi, i rizgjedhur për të tretin mandat radhazi Kryetar i Bashkisë Elbasan), kishte transmetuar përgjatë muajve të fushatës takimet e kandidatit të majtë dhe gjithçka lidhej me veprimtarinë e tij si kryebashkiak.*

*Qytetarët e Elbasanit e kishin të pamundur që të ndiqnin fushatën e kandidatit të djathtë në garë, Ardian Turkut. Gazetarë në këtë televizion pohuan se, nuk mund të mendohej që kundërshtari i tij të kishte hapësirë në televizionin “Skampa”, pronar i të cilit ishte dhe është kundërshtari i tij në këtë garë. Dhe bëhet fjalë për ekranin më të rëndësishëm të një qyteti të madh në Shqipëri, qytetarët e të cilit e*

*patën të të pamundur të informohen për garën mes dy kandidatëve, së paku atë anë të garës që media përcjell.*

*Por kjo është vetëm njëra anë, sepse kandidati – pronar i televizionit, për të qenë korrekt me hapësirën televizive që duhet të kenë partitë politike në kohë fushate elektorale, vendosi që në vend të Z. Turku, të transmetonte ‘me korrektesë’ fushatën elektorale të kandidates së djathtë Grida Duma e cila kandidonte për Bashkinë Durrës. Ishte kjo zgjidhja e gjetur nga pronari – kryebashkiak i televizionit “Skampa” për të qenë në rregull me ligjin.*

*Ndërsa përtej fushatës, është e kuptueshme që banorët e Elbasanit nuk mund të informohen dhe as të gjejnë problematikat e qytetit në këtë ekran! Dhe as që mund të flitet për çështje që janë interes dhe nevojë e tyre e që mund të shkojnë në kundërshtim me interesin e kryetarit të bashkisë.*

Përtej këtij shembulli, lajmet apo problematikat sociale të komuniteteve në të shumtën e rasteve mungojnë në këto media, ndonëse audienca pret të kundërtën!

Nga ana tjetër, nevoja për informacion lokal urban është, në fakt, kërkesë për të rikrijuar virtualisht lidhjet sociale të shprishura dhe të zbehura fort nga ai që quhet proces atomizimi i shoqërisë urbane. Familja mbyllet disi brenda vetes. Individit e ka të vështirë që të njohë të tjerët që e rrethojnë në lagjen e tij apo qytetin ku ai jeton<sup>3</sup>.

Megjithë audiencën potenciale për të konsumuar informacionin e medias lokale, aktualisht mungesa reale e kësaj lloji mediaje, sjell inekzistencë të informacionit televiziv më te detajuar, me afër jetës dhe interesit direkt të qytetarëve.

Dihet nga teoria e informacionit masiv se sa më pranë të jetë informacioni gjeografikisht me shqetësimet e audiencës, sa më afër të jetë me shqetësimet e jetës së saj, aq më e interesuar bëhet kjo audiencë për mediat<sup>4</sup>.

Por sot, media lokale është shumë larg kërkesës, nevojës dhe interesit të audiencës së saj. Cilësia e gazetarisë që këto media bëjnë,

---

<sup>3</sup> Fuga, Artan. Komunikimi në Shoqërinë Masive, Papirus, Tiranë 2015. F.503

<sup>4</sup>Po aty

cilësia e prodhimit dhe e transmetimit determinojnë rolin e saj të munguar në hapësirën ku transmetojnë e për të cilën ekzistojnë.

### **Media lokale, gazetarët dhe digjitalizimi**

Njësoj si mediave kombëtare dhe atyre me licencë lokale me sinjal transmetimi në pjesën më të madhe të territorit të vendit, në epokën e transmetimeve digjitale, rreziku që u kanoset veçmas medimeve lokale, është përherë e më i madh.

Me kapacitetin aktual, me burimet njerëzore dhe financiare që ato kanë aktualisht, është shumë e vështirë që të përmbushin standardet e këtij procesi dhe të vijojnë të ekzistojnë.

Disa fakte:

- a) Rreth 62 % e gazetarëve të anketuar janë të formuar në gazetari/komunikim;
- b) ...por rreth 40 % e tyre mendojnë se media ku ata punojnë, nuk e ka të mundur që të përdorë mediat e reja për të përmbushur më mirë misionin e tyre;
- c) 81 % e tyre i përdorin pajisjet smart (celularë, tablet)
- d) ....por 62 % e tyre nuk i kanë përdorur asnjëherë këto pajisje elektronike për të bërë një raportim LIVE për median ku ata punojnë.<sup>5</sup>

Përtej dhe pas këtyre fakteve, megjithëse sot, pjesa më e madhe e reporterëve të cilët janë të punësuar pranë mediave lokale, kanë përfunduar studimet kryesisht për gazetari apo në fusha të përfaqëta, e kanë të vështirë të kryejnë si duhet misionin e tyre, shpesh të diktuar nga kushtet në të cilat e ushtrojnë profesionin.

Sepse, lajmi është gjithashtu çfarë gazetari vendos të bëjë me të. Por, se si gazetari e bën lajmin, varet nga mjedisi dhe kushtet e tij të punës. Dhe mjedisi i tyre i punës është i përcaktuar nga faktorët ekonomikë, sociale, politikë dhe teknologjikë (Fenton, N. pg. 16).

---

<sup>5</sup>Uni.Beder. 2016. *Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive". Anketë, Tiranë: SHL "Hëna e Plotë" (Bedër).*

Dhe kushtet në të cilat gazetarët lokalë duhet të prodhojnë informacion dhe më pas ai të emetohet, sipas vetë administratorëve janë këto:

- a) Rreth 69 % e operatorëve lokalë dhe rajonalë nuk kanë asnjë studio të lëvizshme;
- b) Një ekipi gazetarësh u duhet të punojnë në rastin më të mirë me 4 kamera gjithësej, në terren dhe në studio, teknologji e vitit 2005.
- c) Gjithçka duhet të kalojë në transmetim, nga vetëm 1-2 pika montazhi<sup>6</sup>

Përtej pohimeve të administratorëve / pronarëve të mediave lokale, infrastruktura dhe teknologjia që ata kanë në përdorim, nuk lejon reporterin e medias lokale, as të prodhojë dhe as të transmetojë produktin mediatik të standardizuar. Gazetarët e punësuar pranë operatorëve lokalë janë përherë e më të paktë në numër dhe megjithë deklaratimet e administratorëve, ka shembuj televizioneve lokale në të cilat të punësuar janë vetëm 2 gazetarë dhe 1 kameraman dhe në transmetim kanë vetëm 1 person i cili është multi-funksional dhe shërben si montazhier, kameraman, regjisor e teknik transmetimi.

Edhe në rastet e televizioneve lokale që nuk funksionojnë në këto kushte të burimeve njerëzore, punonjësit e këtyre mediave nuk kanë infrastrukturën për të qenë në kontakt me komunitetin. Ata e kanë të pamundur të përmbushin një ndër misionet e tyre, kontaktin direkt me komunitetin për të cilin transmetojnë dhe përcjelljes në ekran të asaj çka atyre u intereson të shohin; të asaj çka i shqetëson.

Nga ana tjetër, gazetarët e mediave lokale dhe rajonale nuk janë të specializuar në fusha të posaçme, siç ndodh me reporterët e mediave gjeneraliste që transmetojnë nga Tirana. Ndonëse kjo nuk është një ndër pengesat më të mëdha me të cilat përballlet gazetaria dhe media lokale, është një element tepër i rëndësishëm i cili ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe standardin profesional të tyre.

Në këto kushte, për median lokale dhe atë rajonale, përvijimi i procesit të digjitalizimit sipas të gjitha gjasave do të rezultojë 'fatal' pasi nuk kanë as burime njerëzore të përgatitura për të përballuar

---

<sup>6</sup>Po aty

procesin dhe sidomos nuk kanë burime financiare për të investuar në teknologji, e cila në këtë proces, shndërrohet në një hallkë edhe më thelbësore nga sa ka qenë deri tani.

Ky është realitet i operatorëve ndonëse rreth 68% e pronarëve të televizioneve lokale kanë në pronësi edhe një biznes tjetër. Faktet sot flasin për investime në nivelin e zeros të operatorëve lokalë, veç investimit fillestar të kryer në këto media në momentin e hapjes së tyre.

Por procesi i digjitalizimit është rrugë pa kthim dhe në kushtet kur gazetarët punojnë në kushtet e 'padijes' së ndryshimeve që sjell ky proces jo vetëm teknologjik dhe pronarët / administratorët gjithashtu, pasojat pritet të jenë jo të vogla për një numër të konsiderueshëm të operatorëve lokalë dhe rajonalë.

### **Përfundime**

Media lokale, në kushtet aktuale të ekzistencës së saj, do ta ketë shumë të vështirë në mos të pamundur mbijetesën pasi procesi i digjitalizimit i cili po përvijohet, do të ketë pasoja të mëdha dhe shumë direkte në veprimtarinë e operatorëve lokalë dhe rajonalë. Pjesa më e madhe e tyre deri sot, kanë ekzistuar në kushtet e piraterisë e cila ka lulëzuar në këtë kënd të transmetimeve audiovizive; në kushtet e një tregu aspak të rregulluar sa i takon standardit profesional të prodhimit dhe transmetimit.

Vijimi dhe ekzistenca e saj kërcënohen edhe më tej prej faktit se gazetarët dhe profesionistët e tjerë të operatorëve lokalë nga njëra anë dhe pronarët / administratorët nga ana tjetër, nuk janë aspak të qartë dhe vepronë në kushtet e mungesës së informacionit për sfidat dhe vështirësitë më të cilat duhet të përballen me përvijimin e këtij procesi.

Pa investime në teknologji për të prodhuar dhe transmetuar në standardin e medias digjitale, operatorët lokalë do ta kenë të vështirë të transmetojnë pas një periudhe shumë të shkurtër kohore.

Dhe në fund, një gjë është e sigurtë: Nëse këta operatorë lokalë dhe rajonalë gjithkund në territorin e Shqipërisë, nuk përmbushin kriteret për t'u kyçur në platformat digjitale, nëse nuk do të



përbushin kriteret për transmetimin digjital, do ta kenë të pamundur ekzistencën!

### **Bibliografia**

Balle, Francis. Mediat dhe Shoqëritë, Botim, shtyp, kinema, Radio, Televizion, Internet.

(T. Nakuçi; S. Pasho, M. Marku), Papirus, Tiranë 2015.

Fuga, Artan. Komunikimi në Shoqërinë Masive, Papirus, Tiranë 2015.

Fenton, Natalie. Në media, old journalism, Sage, London 2010.

Uni.Beder. 2016.*Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre*. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive", Tiranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër).